

## GJYKATA E APELIT

**Numri i lëndës:** PaKr 35/14

**Data:** 25 prill 2014

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarës së EULEX-it Annemarie Meister kryetare e kolegjit dhe gjyqtare raportuese, dhe gjyqtarëve kosovar të Gjykatës së Apelit Fillim Skoro dhe Xhevdet Abazi si anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor të EULEX- it Andres Parmas i cili vepron në cilësinë e procesmbajtësit, në lëndën penale kundër

**Z.V.**, i dënuar në shkallën e parë për veprën penale të **Mbajtjes në pronësi, në kontroll, ose në posedim të paautorizuar të armëve** sipas nenit 374 (2) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. (KPRK);

*duke vepruar sipas ankesës së përbashkët të avokatëve mbrojtës Faruk Korenica dhe Dejan A. Vasiq*, e ushtruar më 30 dhjetor 2013 kundër **aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës nr. P 946/13 të datës 20 nëntor 2013** dhe dërguar tek avokatët mbrojtës më 18 dhjetor 2013;

*duke pasur parasysh* përgjigjen nga Zyra e Prokurorisë së EULEX-it në Mitrovicë e parashtruar më 23 janar 2014;

*duke pasur parasysh* edhe mendimin e prokurorit të apelit nga Zyra e Prokurorisë së Shtetit, nr. PPA/I.-KTŽ 47/14 të datës 30 janar 2014 dhe të parashtruar po të njëjtën ditë;

*pas mbajtjes së seancën së hapur më 27 mars 2014 me të gjitha palët e ftuara sipas rregullit, në praninë e prokurorit të apelit Kari Lamberg;*

*pas këshillimit dhe votimit më 25 prill 2014,*

në pajtueshmëri me nenet nga 398 e më pas të Kodit të procedurës penale (KPP)

*lëshon këtë*

---

### AKTGJYKIM

---

1. **Refuzohet** ankesa e përbashkët e avokatëve mbrojtës e ushtruar më datën 30 dhjetor 2013 kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës nr. P 046/13 të datës 20 nëntor 2013.

## **2. Vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore.**

### **ARSYETIMI**

#### **I. Historia e procedurës së lëndës**

1. Më 25 tetor 2013 prokurori ngriti aktakuzën PP Nr. 157/2013, duke e akuzuar Z.V. për veprën penale të Mbajtjes në pronësi, në kontroll, ose në posedim të paautorizuar të armëve sipas nenit 374 (1) të KPRK-së dhe Vrasjes së rëndë në tentativë sipas neneve 20 dhe 147 (1.10) të Kodit të vjetër penale të Kosovës (i ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 26/2004, tash e tutje në tekst KPK).
2. Gjatë shqyrtimit fillestar më 13 nëntor 2013 i pandehuri pranoi fajësinë për akuzën e mësipërme të armës. Pasi që kryetari i trupit gjykues konsideroi se kushtet për pranimin e fajësisë sipas nenit 248 (1) të KPP-së janë plotësuar, kjo akuzë u nda nga akuza tjetër e ngritur me një aktvendim verbal të Gjykatës Themelore të Mitrovicës të datës 13 nëntor 2013. Në përputhshmëri me nenet 38 (1) dhe 248 (4) të KPP-së kryetari i trupit gjykues vazhdoi tutje me dënimin për akuzën e ndarë.
3. Kryetari i trupit gjykues e dënoi Z.V.in me burgim prej nëntë muajsh me kusht për një periudhë verifikimi prej dy vjetësh me kushtin që i pandehuri të mos kryej një veprë tjetër penale. Atij i është sekuestruar arma e kundërligjshme bashkë me shtatëmbëdhjetë fishekë.
4. Kur përcaktoi dënimin për të pandehurin, kryetari i trupit gjykues si rrethanë lehtësuese e mori në konsideratë se Z.V.i e deklaroi pranimin e fajësisë në mundësinë e parë, se i pandehuri nuk kishte dënime të mëhershme dhe se ai bashkëpunoi me prokurorinë në lidhje me këtë akuzë. Si rrethana rënduese, gjykata mori parasysh se i pandehuri ka bartur armë për një kohë të gjatë, d.m.th prej vitit 2009 dhe këtë e ka bërë në vende të hapura publike. Arma ka qenë tërësisht funksionale dhe e mbushur derisa ka qenë në vende publike. I pandehuri – kur është orvatur të ikë nga policia e hodhi armën në vend publik. Gjukata po ashtu ka vënë peshë rënduese në faktin se Z.V.i u përpoq t'i shmanget paraburgimit dhe të ikë nga policia. Gjukata nuk e kishte pranuar se frika për sulm e të pandehurit është dashur të konsiderohej rrethanë lehtësuese.

#### **II. Parashtrësat e palëve**

##### **1. Ankesa**

5. Më 30 dhjetor 2013 avokatët mbrojtës F. Korenica dhe D.A. Vasic ushtruan ankesë të përbashkët kundër vendimit të mësipërm të kryetarit të trupit gjykues. Ankuesit propozojnë që vendimi i kryetarit të trupit gjykues për dënimin e Z.V.it të ndryshohet dhe i pandehuri të dënohet vetëm me një gjobë ose dënim me kusht për një periudhë më afat shkurtër dhe me

periudhë verifikimi më të shkurtër. Si alternativë ata propozojnë që lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje.

6. Avokatët mbrojtës pohojnë se kryetari i trupit gjykues gabimisht nuk mori në konsideratë një numër të madh rrethanash lehtësuese. Ata theksuan se Z.V.i ka qenë shumë i ri (28) në kohën e kryerjes së veprës. I pandehuri është i vetmi mbajtës i familjes së tij me dy fëmijë të vegjël. Gruaja dhe njëri nga fëmijët e tij kanë shëndet të dobët dhe kanë nevojë për mbikëqyrje mjekësore pothuajse të përhershme. Po ashtu i pandehuri përkujdeset edhe për prindërit e tij të sëmurë. Vepra penale ka ndodhur në një vend të vetmuar pa qenë publiku i pranishëm. I pandehuri ka mbajtur armë për mbrojtje personale dhe ka pasur shqetësim të arsyetuar për sigurinë e tij fizike. Dënimi i shqiptuar ndaj Z.V.it nuk është në përputhshmëri me dënimet të shqiptuara zakonisht për vepra të ngjashme penale nga gjykatat e Kosovës. Për këtë veprë zakonisht kryerësit vetëm gjobiten.
7. Ankuesit gjithashtu kundërshtojnë ekzistimin e rrethanave rënduese sikurse janë vërtetuar nga kryetari i trupit gjykues. Fakti se Z.V.i ka pasur armë për disa vjet nuk mundë të konsiderohet si rrethanë rënduese sepse pronësia e armës është tashmë element konstituivë i veprës penale sipas nenit 374 të KPRK-së – nuk duhet medoemos t'i jepet peshë e dyfishtë kur të dënohet një person. Ngjashëm, bartja e armës në vend publik nuk duhet të konsiderohet si rrethanë rënduese sepse kjo gjithashtu është përfshirë me *actus reus* të veprës. Duhet të merret parasysh se Z.V.i kishte motiv justifikues të vetë mbrojtjes për bartje të armës dhe do të ishte e pakuptimtë nëse arma nuk do të bartej në vende publike. Avokatët mbrojtës nuk pajtohen me konstatimin se si rrethanë rënduese duhet të konsiderohet se arma ishte plotësisht funksionale – një armë jo funksionale nuk mundë të konsiderohet as si armë. Duhet të vihet në pah se megjithëse arma ka pasur një fishek në tytë, Z.V.i në fakt nuk ka shtënë në asnjëri e madje as në ajër. Kjo është e pasaktë sepse i pandehuri e ka hedhur armën në vend publik ku çdokush ka mundur ta gjejë. Ai e ka hedhur armën në shkurre dhe kaçuba, në vende të cilave nuk e është lehtë për të iu afruar dhe që zakonisht nuk vizitohen nga ndokush. Nuk mundë të konsiderohet kundër të pandehurit se ai u përpoq t'i shmanget paraburgimit. Ai fillimisht vetëm bëri panik por pastaj vullnetarisht u paraqit tek autoritetet.
8. Duke pasur parasysh praktikën e zakonshme të dënimet për vepra të ngjashme penale nëpër gjykatat e Kosovës, dënimi për Z.V.in është shumë i rëndë.

## **2. Përgjigja e prokurorit**

9. Prokurori i EULEX-it nga Zyra e Prokurorisë Themelore është përgjigjur në ankesë, duke konsideruar se kjo është e pabazuar dhe nuk duhet të qojë në asnjë ndryshim të aktgjykimit të kundërshtuar.

### **3. Mendimi i prokurorit të apelit**

10. Prokurori publik i apelit e shtynë Gjykatën e Apelit të refuzojë ankesën si të pabazuar. Ai argumenton se ankesa është jomeritore; aktgjykimi i kundërshtuar është i arsyetuar mirë.

### **III. Gjetjet e Gjykatës së Apelit**

#### **1. Kompetenca e Gjykatës së Apelit**

11. Gjykata e Apelit është gjykatë kompetente për të vendosur mbi ankesën në pajtueshmëri me nenet 17 dhe 18 të Ligjit mbi gjykatat (Ligji nr. 03/L-199).
12. Kolegji i Gjykatës së Apelit është formuar në përputhshmëri me nenin 19 (1) të Ligjit mbi gjykatat dhe nenin 3 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhja e lëndëve dhe caktimi i lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03/L-053).

#### **2. Ligji procedural në fuqi**

13. Ligji i procedurës penale në fuqi në lëndën përkatëse penale është Kodi (i ri) i Procedurës Penale të Kosovës (KPP) i cili ka hyrë në fuqi më datën 1 janar 2013.

#### **3. Gjetjet mbi meritat**

14. Gjykata e Apelit është e mendimit se ankesa është jomeritore dhe si e tillë duhet të refuzohet për arsyet e mëposhtme.
15. Gjykata e Apelit e vëren se përcaktimi i dënimeve është përgjegjësi parësore e gjykatës ku kryhet gjykimi ndërsa gjykata e apelit gjatë shqyrtimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, duhet të përqendrohet vetëm në gabimet procedurale apo materiale të bëra gjatë shqiptimit të dënimeve. Dënimi për Z.V. mbetet shumë nën mesataren e dënimit të zbatueshëm për veprat penale për të cilat ata janë shpallur fajtorë. Dënimi në fjalë është pezulluar. Në aktgjykimin e kundërshtuar trupi gjykues në mënyrë adekuate ka arsyetuar qëndrimin e vet lidhur me ashpërsinë e dënimit, duke u bazuar në shkallën e fajësisë së të pandehurit siç rezulton nga faktet e vërtetuara në këtë lëndë. Gjykata e Apelit nuk e sheh asnjë arsye për t'i kundërshtuar këto përfundime.
16. Lidhur me argumentet e avokatëve mbrojtës se një numër i madh i rrethanave lehtësuese pa të drejtë nuk janë marrë parasysh, Gjykata e Apelit vëren se nuk mund të pajtohet me asnjë prej këtyre kritikave. Mosha e Z.V.it në kohën kur është kapur duke e kryer veprën penale në fjalë – 28 vjeçare – në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si moshë shumë e re. Mosha minimal e përgjegjësisë penale në Kosovë është 14 vjeç. Personi konsiderohet si i

rritur dhe në zotërim të shumicës së të drejtave civile qysh në moshën 18 vjeçare. Duke qenë se tashmë ka kohë që e ka kaluar atë moshë, tashmë është njeri familjar dhe baba i dy fëmijëve, nuk ka kurrfarë arsye të pretendohet se moshja 28 vjeçare është moshë shumë e re.

17. Është e vërtetë se Gjykata e shkallës së parë nuk ka diskutuar në mënyrë eksplicite se Z.V. është i vetmi mbajtës i familjes. Megjithatë, Gjykata e Apelit nuk e sheh asnjë shkelje në këtë drejtim. Vetë fakti se personi i dënuar ka familje apo qoftë edhe nëse është siguresi i vetëm i kafshatës së gojës për familjen, nuk mund të shërbejë automatikisht si luks apo si zbutje për fajin e tij. Është vlerësimi i trupit gjykues nëse këto fakte në lëndën specifike mund ta zbusin fajin e të akuzuarit. Po qe se trupi gjykues e sheh këtë si të udhës, i duhet të japë arsyet për një konkluzion të tillë në kuadër të aktgjykimit. Po ashtu, në qoftë se gjykata nuk pajtohet me kërkesën eksplicite të mbrojtjes lidhur me këtë aspekt, arsyet e tilla duhet të prezantohen në aktgjykim. Megjithatë, nëse argumente të tilla nuk parashtrohen gjatë shqyrtimit gjyqësor (ose gjatë fazës së deklarimit rreth fajësisë) dhe nëse gjykata që e kryen gjykimin nuk e sheh asnjë arsye specifike për ta diskutuar rolin lehtësues të rrethanave familjare të të akuzuarit, kjo nuk ka nevojë të diskutohet në kuadër të aktgjykimit. E njëjta gjë vlen edhe për argumentet e mbrojtjes lidhur me gjendjen e dobët shëndetësore të anëtarëve të familjes së Z.V. dhe obligimin e tij për t'u kujdesur për ta.
18. As argumenti lidhur me vetëmbrojtjen e pohuar si arsye për bartjen e armës nuk duhet të konsiderohet si rrethanë lehtësuese, për shkak se nuk ka prova për ndonjë kërcënim të afërt ndaj personalitetit të të pandehurit, i cili do të mund të merrej në konsideratë.
19. Gjithashtu nuk mund të pajtohem me pretendimin se vepra në fjalë është kryer në një vend ku nuk ka pasur prani të publikut. Është e qartë qoftë edhe nga pretendimet e mbrojtjes se Z.V. ka qenë duke bartur armë kur ka lëvizur poshtë e lart dhe këtë e kishte bërë për vite me radhë. Vetëm pak para se të arrestohej, ai e kishte hedhur armën në një vend të hapur për publikun. Fakti që pikërisht në çastin kur e kishte bërë këtë nuk kishte njerëz të tjerë që po lëviznin andej është fakt plotësisht i parëndësishëm.
20. Gjykata e Apelit nuk pajtohet me thjesht spekulimin e parashtruesve të ankesave se zakonisht kryerësit e veprave të ngjashme penale në Kosovë dënohen vetëm me gjoja. Pretendimi i parashtruesve në atë aspekt nuk është i mbështetur me asnjë të dhënë statistikore as që mund të mbështetet, ngase dënimet për posedim të paautorizuar të armëve dallojnë dukshëm nga lënda në lëndë.
21. Gjykata e Apelit nuk pajtohet as me kritikën e mbrojtjes lidhur me shqyrtimin gjoja të gabueshëm të rrethanave rënduese. Së pari, fakti që Z.V. ka qenë në posedim të armëve të kundërligjshme me vite me radhë, është arsye e vlefshme e cila ia rëndon fajësinë. Vepra e mbajtjes në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve është një vepër e

vazhdueshme, serioziteti i së cilës varet mes tjera rrethanash në mënyrë të qartë edhe nga kohëzgjatja e aktivitetit të kundërligjshëm. Është vërtetuar se Z.V. ka qenë në posedim të armës për një periudhë të gjatë kohore, prandaj fajësia e tij në mënyrë adekuate është vlerësuar të jetë më e madhe sesa do të kishte qenë në rast se do të kishte qenë në pronësi të armës për një afat të shkurtër kohor.

22. Ajo çfarë ka të bëjë me faktin se arma në fjalë është bartur lart e poshtë nëpër vende publike, edhe kjo është vlerësuar në mënyrë korrekte si një rrethanë rënduese. Kjo nuk është në vete element përbërës i veprës penale të përcaktuar në nenin 374 të KPRK-së siç është sugjeruar nga parashtruesit e ankesës. Ky nen nuk përmban asnjë referencë lidhur me këto vende publike, përderisa ka shumë dallim ku është mbajtur arma në fjalë dhe në çfarë rrethana. Në lëndën tonë, është vërtetuar se Z.V. ka bartur armën poshtë e lart, të mbushur dhe të gatshme për të shtënë me të. Kjo gjë e sjell Gjykatën e Apelit tek argumenti i radhës së avokatëve mbrojtës se mbajtja e një arme jofunksionale nuk do të përbënte veprë penale. Një argument i tillë është vetëm pjesërisht i vlefshëm. Po të ishte kështu, atëherë kur dikush mban armë e cila efektivisht dhe përfundimisht është sjellë në gjendje jofunksionale, vërtet kjo nuk do të përbënte veprë penale. Megjithatë, në qoftë se një arme thjesht i hiqen fishekët apo çmontohet, posedimi i saj prapë është i dënueshëm, edhe pse kërcënimi i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm është dukshëm më i ulët sesa në rastin e armës së mbushur dhe në gjendje plotësisht funksionale. Z.V. po mbante një armë e cila ishte e gatshme për të shtënë me fishek të vendosur në tytë dhe një rrethanë e tillë është vlerësuar me të drejtë si rrethanë rënduese nga ana e trupit gjykues.
23. Gjykata e Apelit po ashtu pajtohet me konkluzionin e trupit gjykues se faji i Z.V. rëndohet me faktin se duke u munduar t'i shmangej kapjes e kishte hedhur armën në një vend publik, ku çdokush ka mundur ta gjente.

Kryetarja e kolegjit

---

Annemarie Meister  
Gjyqtare e EULEX-it

Anëtari i kolegjit

---

Fillim Skoro  
Gjyqtar

Anëtari i kolegjit

---

Xhevdet Abazi  
Gjyqtar

Procesmbajtësi

---

Andres Parmas  
Zyrtar ligjor i EULEX-it

*Përgatitur në gjuhën angleze si gjuhë e autorizuar. Aktgjykimi i arsyetuar është përfunduar dhe nënshkruar më datën 25 prill 2014.*